

20 shkurt

I LUMI LUIGJ PALIĆ (PALIQ), MESHTAR E MARTIR

PËKUJTIM

Meshtar i Fretërve Minorë të Shqipërisë (1877-1913), Luigj Palić, në shqip Paliq, ishte famullitar në Pejë, që në atë kohë i përkiste Arqidioqezës së Shkupit. Gjatë Luftës së Parë Ballkanike (1912-1913) u ushtrua një presion i madh mbi besimtarët myslimanë e katolikë për ruajtjen e ortodoksisë. I Lumi i nxiste katolikët dhe myslimanët që secili t'i qëndronte besnik ndërgjegjës së vet. U arrestua me akuzën e rreme, nuk pranoi në mënyrë kategorike të mohonte fenë katolike. Më 7 mars 1913 u pushkatua. Fjalët e tij të fundit ishin: «O Jezus, po e bëj për dashurinë Tënde!».

Nga e Përbashkoria e një martiri, ose nga e Përbashkoria e barinjve: për një bari, me psalmet e ditës në psalter.

SHËRBESA E LEXIMEVE

LEXIMI I DYTË

Nga «Homelitë» e Shën Gjon Palit II, papë

(Otranto, 5 tetor 1980: AAS 72, 1980, 1013-1014)

Të qëndrojmë të bashkuar me martirët

Martirizimi është një provë e madhe, në njëfarë kuptimi është prova përfundimtare dhe radikale. Është prova më e madhe e njeriut, prova e

dinjtetit të njeriut përballë vetë Zotit. Është e vështirë të thuhet më shumë në lidhje me këtë nga sa pohon vetë libri i Urtisë: «Hyji i vuri në sprovë dhe i gjeti të denjë për vetveten» (Ur 3, 5). Nuk ka një masë më të madhe të dinjtetit të njeriut se ajo që gjendet në vetë Zotin: në sytë e Zotit. Pra, martirizimi është “prova” e njeriut që ndodh në sytë e Zotit, një provë në të cilën njeriu, i ndihmuar nga fuqia e Zotit, arrin fitoren.

Nëpërmjet kësaj prove kanë kaluar, përgjatë historisë, shumë dëshmitarë dhe dishepuj të Krishtit. Nëpërmjet kësaj prove kanë kaluar dhe kalojnë martirët e shekullit tonë, martirë shpesh të panjohur, ose pak të njohur, edhe pse ndodhen jo larg nesh.

Dhe kështu nuk mund të mos hedh sytë, përtej detit, tek Kisha heroike jo e largët në Shqipëri, e tronditur nga një përndjekje e ashpër dhe e gjatë, por e pasuruar nga dëshmia e martirëve të saj: ipeshkvij, priftërinj, rregulltarë, rregulltare dhe besimtarë të thjeshtë.

Përveç tyre, mendja ime shkon edhe tek vëllezërit e tjerë të krishterë dhe të gjithë besimtarët në Zotin, të cilët përjetojnë të njëjtën fatkeqësi privimesh.

Të jemi shpirtërisht pranë të gjithë atyre që pësojnë dhunë për shkak të fesë të tyre është një detyrë e veçantë e të gjithë të krishterëve, sipas traditës së trashëguar nga shekujt e parë. Do të thoja më shumë: këtu bëhet fjalë edhe për një solidaritet të detyruar ndaj individëve dhe bashkësive, të cilëve u shkelen apo edhe u mohohen plotësisht të drejtat themelore. Duhet të lutemi që Zoti t’i mbështesë këta vëllezër me hirin e tij në këto prova të vështira. Dhe duam të lutemi gjithashtu për ata që i përndjekin, duke përsëritur thirrjen e Krishtit në kryq drejtuar Atit: «Fali ata, sepse nuk dinë çfarë bëjnë».

Shumë shpesh martirët përpiqen të cilësohen si fajtorë për krime politike. Edhe Krishti u dënua me vdekje, në dukje për këtë arsye: sepse pohonte se ishte mbret (krh. Lk 23, 2). Mos t’i harrojmë, pra, martirët e

kohëve tona. Mos të sillemi sikur ata nuk ekzistojnë. Ta falënderojmë Zotin që ata e kanë kaluar provën me fitore. Të kërkojmë forcën e Shpirtit Shenjt për të përndjekurit që ende duhet të përballen me këtë provë. U plotësofshin në ta fjalët e mësuesit: «Unë do t’ju jap zotësinë e fjalës dhe urtinë, të cilën s’do të mund ta kundërshtojë as t’i bëjë ballë asnjë nga kundërshtarët tuaj» (Lk 21, 15).

Të qëndrojmë të bashkuar me martirët. Ata gërmojnë shtratin më të thellë të lumit hyjnor në histori. Ata ndërtojnë themelet më të qëndrueshme të atij qyteti hyjnor që ngrihet drejt amshimit.

PËRGJIGJA

KRH. UR 3,1,5-6

R. Shpirtrat e të drejtëve janë në dorën e Hyjit dhe ata s’do t’i prekë asfarë vështirësie e vdekjes. Për një vuajtje të lehtë do të fitojnë të mira të mëdha, * sepse Hyji i vuri në sprovë dhe i gjeti të denjë për vetveten.

V. I sprovoi porsi arin në furrë dhe i pranoi porsi fli shkumbimi.

R. sepse Hyji i vuri në sprovë dhe i gjeti të denjë për vetveten.

LUTJA

O Atë, që të Lumit martir Luigj [Paliqit], meshtar, i ke dhënë hirin për ta ruajtur në fenë katolike grigjën që atij i është besuar dhe për ta derdhur gjakun për dashuri të Krishtit, nën shembullin dhe për ndërmjetësi të tij bëj që t’i duam të gjithë dhe të jemi në Kishë e në botë shenjë njësie e paqeje. Nëpër Zotin tonë.